

<p style="text-align: center;"><b>CONFERENCE</b> World Metrology Day</p> <p>"The role of Metrology in the Stabilisation and Association Agreement process with EU- Results of the survey on metrology needs"</p> <p style="text-align: center;">Prishtina, May 22, 2015 Hotel Sirius, room Andromeda Agim Ramadani str, 10 000 Prishtina</p>	<p style="text-align: center;"><b>KONFERENCA</b> Dita botërore e metrologjisë</p> <p style="text-align: center;">"Roli i metrologjisë në procesin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me EU - Rezultati i hulumtimit mbi nevojat metrologjike"</p> <p style="text-align: center;">Prishtinë, 22 maj 2015 Hotel Siriusi, dhoma Andromeda rr. "Agim Ramadani" 10 000 Prishtinë</p>
--	---

## *Presentation*

The Feasibility Study for a Stabilisation and Association Agreement (SAA) between the EU and Republic of Kosovo was published in October 2012 and the negotiations were fully concluded in July 2014. The European Commission regularly issues an annual Progress Report Report assessing Kosovo's progress towards the European Union:

*“Overall, Kosovo has continued to improve the alignment of its legislation with the acquis in the area of free movement of goods. Its administrative capacity has also improved, notably through the reorganisation of the MTI. Further efforts are needed to strengthen administrative capacity to ensure enforcement of legislation, and to provide valuable services to industry. Coordination between ministries and various agencies needs to be improved.”*

The «Support to the Free Movement of Goods» (FMG) project is of significant relevance both to Kosovo and to the EU, since it is intended to be one of the important elements for the gradual integration of Kosovo within the European Union. It will aim to facilitate trade and free movement of goods through fostering legal, regulatory and institutional reforms in Kosovo's quality infrastructure, market surveillance and consumer protection sectors. This will enhance compliance of Kosovo legislation with the *Acquis Communautaire*. The project will strengthen not only the prospects of Kosovo satisfying the EU SAA demands but it will also help Kosovo to meet the WTO membership requirements.

In the area of metrology, it will aim at extensive training and capacity building of the laboratory staff of Kosovo Metrology Agency (KMA). The main result for this component as outlined in the Terms of Reference reads: “Modern and functional laboratories of metrology will be handled by properly trained staff.” This will require also an internal Quality Management System (QMS) to international standards to be developed and applied at KMA. The staff participation in laboratory comparisons and in other international work, including their attendance at meetings of international metrology organizations will also be necessary and will be supported by the project.

There are four main technical components of the project (related to Quality Infrastructure), and five out of a total of nine are either non-technical, or technical-related to additional elements of FMG, such as Consumer Protection and Market Surveillance.

The role of Metrology in supporting the Kosovar stakeholders in granting the conformity to the standards for their products is essential for surviving in the European and International markets.

The conference will permit to give a general overview of the situation in the Country and the results of the survey on the needs of the country.

*For further information, please contact:*

Project: Support to the free Movement of Goods-Kosovo

Mrs Blerina Lloncari  
Office Manager  
c/o Ministry of Trade and Industry  
Prishtina  
Republic of Kosovo  
Tel: +386 (0)49 366 776  
E-mail: [lloncari@ibf.be](mailto:lloncari@ibf.be)

## *Prezentim*

Studimi i fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës u publikua në tetor të vitit 2012 dhe negociatat u përmyllën plotësisht në korrik të 2014. Komisioni Evropian boton me rregull çdo vit Raportin e Progresit, që e shqyrton progresin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian:

*"Në përgjithësi, Kosova ka vazhduar të përmirësojë rradhitjen e legjislacionit të vet me acquis-të në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Kapaciteti administrativ gjithashtu është përmirësuar, sidomos përmes riorganizimit të MTI-së. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejme për fuqizimin e kapacitetit administrativ për të siguruar zbatimin e legjislacionit, dhe për të ofruar shërbime të vlefshme për industrinë. Koordinimi në mes të ministrive dhe agjencive të ndryshme duhet të përmirësohet."*

Projekti "Përkrahje e lëvizjes së lirë të mallrave (Support to the Free Movement of Goods)" (LLM) është i një rëndësie të veçantë për Kosovën dhe BE-në, sepse synon të jetë një ndër elementet kyçe për integrimin gradual të Kosovës brenda Bashkimit Evropian. Ky projekt ka për qëllim të ndihmojë tregtinë dhe lëvizjen e lirë të mallrave përmes përkrahjes së reformave ligjore, rregullatore dhe institucionale në infrastrukturën e cilësisë, në mbikëqyrjen e tregut, dhe në sektorët për mbrojtjen e konsumatorit në Kosovë. Kjo do të rrisë pajtueshmërinë e legjislacionit kosovar me *Acquis Communautaire*. Projekti do të përforcojë jo vetëm perspektivën e plotësimin të kërkesave të EU SAA nga ana e Kosovës, por edhe do t'i ndihmojë Kosovës në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Në fushën e metrologjisë, qëllimi është trajnimi gjithëpërfshirës dhe ndërtimi i kapaciteteve të stafit të laboratoreve të Agjencisë Kosovare të Metrologjisë (AKM). Rezultati kryesor i kësaj komponenteje, si është theksuar në termat e referencës, është që "labororet moderne dhe funksionale të metrologjisë do të përdoren nga stafi i trajnuar në mënyrë adekuate". Kjo do të kërkojë edhe një Sistem të brendshëm për Menagjim të Cilësisë bazuar në standardet ndërkombëtare, të zhvilluar dhe të zbatuar në AKM. Pjesëmarrja e stafit në krahasimet ndërlaboratorike dhe në punë tjera ndërkombëtare, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në mbledhje të organizatave ndërkombëtare të metrologjisë, do të jetë e domosdoshme dhe do të përkrahet nga ky projekt.

Projekti ka katër komponente kryesore teknike (të gjitha të ndërlidhura me Infrastrukturën e Cilësisë), përderisa pesë nga gjithsej nëntë janë ose joteknike, ose të lidhura me komponentet teknike plotësuese të LLM, si për shembull Mbrojtja e Konsumatorit dhe Mbikëqyrja e Tregut.

Roli i metrologjisë në përkrahjen sigurimit të pajtueshmërisë së prodhimeve të palëve të interesit kosovare me standardet është thelbësore për mbijetesë në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.

Konferenca do të mundësojë dhënien e një pasqyre të përgjithshme të situatës në vend dhe do të paraqesë rezultatet e hulumtimit mbi nevojat metrologjike të Kosovës.

*Për informata më të hollësishme, ju lutemi kontaktoni*

Projekti : Përkrahje lëvizjes së lirë të mallrave - Kosovë

Zonja Blerina Lloncari

Drejtuese e zyrës

c/o Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +386 (0)49 366 766

E-mail: [lloncari@ibf.be](mailto:lloncari@ibf.be)

**Programme****Programi**

9:00	Registration	Regjistrimi
9:30	<p><b>Introduction</b>  <i>Chairperson: Irfan Lipovica</i>  The “FMG” project from the beneficiary Hykmete Bajrami, Minister of MTI</p> <p>The EU approach,  Corinne Deleu, EU representative</p> <p>The main goals of the “FMG” project  Daniela Clejanu, Team leader</p>	<p><b>Hyrje</b>  <i>Drejtues: Irfan Lipovica</i>  Projekti LLM nga përfituesi Hykmete Bajrami, Ministere e MTI-së</p> <p>Qasja e BE-së  Corinne Deleu, Përfaqësuese e BE-së</p> <p>Qëllimet kryesore të projektit LLM  Daniela Clejanu, udhëheqëse e ekipi</p>
10:15	<p><b>Technical issues</b>  <i>Chairperson: Daniela Clejanu, Team Leader</i>  The role of metrology: needs and challenges  Luc Erard, KE3 expert</p>	<p><b>Çështjet teknike</b>  <i>Drejtuese: Daniela Clejanu, udhëheqëse e ekipi</i>  Roli i metrologjisë: nevojat dhe sfidat  Luc Erard, KE3 ekspert</p>
10:35	<p>The main goals of the metrology component of the project  Luc Erard, KE3 expert</p>	<p>Qëllimet kryesore të komponentës metrologjike të projektit  Luc Erard, KE3 ekspert</p>
10:55	Coffee break	Pushim kafeje
11:15	<p>The Kosovo national infrastructure in metrology and the role of KMA  Musa Misini, a.d. KMA General director</p>	<p>Infrastruktura kombëtare e metrologjisë në Kosovë dhe roli i AKM-së  Musa Misini, u.d. AKM drejtor gjeneral</p>
11:35	<p>Results on the survey on country needs  Ardian Gojani, Junior short term expert</p>	<p>Rezultatet e hulumtimit mbi nevojat vendore  Ardian Gojani, Ekspert junior me kontratë të shkurtë</p>
11:55	<p><b>Round table</b>  <i>Chairperson: Luc Erard, KE3 expert</i>  Participants: Business entities, Universities, Authorities, Business associations</p>	<p><b>Tryeza e rrumbullakët</b>  <i>Drejtues: Luc Erard, KE3 ekspert</i>  Pjesëmarrës: entitete biznesi, universitare, autoritete, shoqata biznesore</p>
12:25	Conclusions	Përfundimet
12:30	Closing cocktail	Koktej përmbyllës